

## PROGRAMI I TRANSPARENCËS AVOKATURA E SHËTETIT

*Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim LDI) Autoriteti Publik (Avokatura e Shtetit, në vijim ASH) publikon Programin e Transparencës (PT) të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.*

*Avokatura e Shtetit publikon informacion sipas veprimtarisë së saj funksionale, si dhe do të rishikojë e përditësojë PT në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.*

*Në PT së Avokaturës së Shtetit janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të Avokaturës së Shtetit. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit Avokatura e Shtetit vlerëson nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.*

*Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga ASH, përveç rasteve kur ligji i posaçëm ose detyrimet ndërkombëtare parashikojnë ndryshe.*

*Në PT janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, Avokatura e Shtetit mban parasysh interesin e publikut, si dhe të mundësojnë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.*